

VENDIM
Nr. 664, datë 2.9.2026

**PËR MIRATIMIN E KRITEREVE DHE TË PROCEDURAVE TË PËRFSHIRJES
SË ORGANIZATAVE TË SHOQËRISË CIVILE NË OFRIMIN E SHËRBIMEVE TË
KUJDESIT ALTERNATIV NË FAMILJE**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 3, të nenit 26, të ligjit nr. 92/2025, “Për kujdesin alternativ në familje në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

I. DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

1. Ky vendim ka për qëllim miratimin e kriterëve, të procedurave e të mënyrës së përfshirjes së organizatave të shoqërisë civile (në vijim OSHC) në mbështetjen e ofrimit të shërbimeve të kujdesit alternativ në familje, me qëllim garantimin e cilësisë së shërbimeve dhe mbrojtjes së interesit më të lartë të fëmijës.

2. OSHC-të përfshihen në:

a) mbështetjen e identifikimit të fëmijëve dhe familjeve në nevojë për kujdes alternativ, promovimin dhe ndërgjegjësimin për kujdesin alternativ në familje;

b) mbështetjen e bashkisë në proceset e përgatitjes dhe ofrimit të shërbimeve për kujdesin alternativ në familje;

c) ofrimin e trajnimeve dhe mbështetjes së vazhdueshme për familjet kujdestare.

II. KRITERET PËR PËRFSHIRJEN E ORGANIZATAVE TË SHOQËRISË CIVILE

3. Organizatat e shoqërisë civile ofrojnë mbështetje teknike në ofrimin e shërbimeve të kujdesit alternativ në familje, pa të drejtë vendimmarrjeje, sipas fushave të përcaktuara në pikën 2, të këtij vendimi, nëse plotësojnë të gjitha kriteret e mëposhtme:

a) Kriteret ligjore dhe administrative:

i. të jenë të regjistruara sipas legjislacionit në fuqi;

ii. të kenë në objektin e veprimtarisë ofrimin e shërbimeve sociale dhe mbrojtjen e fëmijës;

iii. të mos jenë në procedura falimentimi, likuidimi ose në konflikt interesi me autoritetet vendimmarrëse;

iv. të jenë të pajisura me licencë për ofrimin e shërbimeve shoqërore, kur kjo kërkohej nga legjislacioni në fuqi;

b) Kriteret profesionale dhe teknike:

i. të kenë përvojë të dokumentuar jo më pak se 5 vjet në fushën e mbrojtjes së fëmijës, kujdesit alternativ ose shërbimeve sociale;

ii. të kenë një ekip multidisiplinar të përbërë të paktën nga punonjës socialë dhe/ose psikologë të licencuar;

iii. të zbatojnë metodologji të strukturuar të menaxhimit të rastit, në përputhje me aktet nënligjore përkatëse;

iv. të kenë kapacitete për ofrimin e shërbimeve në mënyrë të vazhdueshme dhe në përputhje me standardet e cilësisë;

c) Kriteret organizative dhe të menaxhimit:

i. të kenë strukturë të qartë organizative dhe përshkrime të roleve dhe përgjegjësi;

ii. të disponojnë politika dhe procedura të brendshme për mbrojtjen e fëmijës, etikën profesionale dhe mbrojtjen e të dhënave personale dhe konfidencialitetin;

iii. të kenë sisteme funksionale për dokumentimin, raportimin dhe ruajtjen e të dhënave;

iv. të zbatojnë mekanizma të brendshëm monitorimi dhe vlerësimi të cilësisë së shërbimeve;

- ç) Kriteret financiare dhe të qëndrueshmërisë:
 - i. të kenë kapacitete të provuara për menaxhimin financiar të fondeve publike ose të donatorëve;
 - ii. të kenë sisteme të brendshme të kontrollit financiar dhe transparencës;
 - iii. të paraqesin evidencë të qëndrueshmërisë financiare për zbatimin e shërbimit gjatë periudhës së kontraktimit;
- d) Kriteret e integritetit dhe sigurisë:
 - i. të zbatojnë procedura për verifikimin e integritetit të stafit (përfshirë kontrollin e figurës për punë me fëmijë);
 - ii. të garantojnë mjedise dhe praktika të sigurta për fëmijët;
 - iii. të respektojnë parimin e interesit më të lartë të fëmijës në çdo ndërhyrje.
- 4. Plotësimi i kriterëve të përcaktuara në pikën 3, të këtij vendimi, vlerësohet nga një komision i ngritur me urdhër të kryetarit të bashkisë, në bashkëpunim me strukturat përgjegjëse, në bazë të dokumentacionit të paraqitur dhe, kur është e nevojshme, nëpërmjet verifikimeve në terren.

5. Dokumentacioni për vlerësimin e organizatave të shoqërisë civile, si dhe vlerësimi përkatës është i përshkruar në shtojcën nr. 1, bashkëlidhur këtij vendimi.

III. PROCEDURAT E PËRFSHIRJES SË ORGANIZATAVE TË SHOQËRISË CIVILE

6. Organizatat e shoqërisë civile përfshihen në mbështetjen e sistemit të kujdesit alternativ në familje, nëpërmjet:

- a) marrëveshjeve të bashkëpunimit me njësitë e vetëqeverisjes vendore për aktivitete mbështetëse, këshilluese, ndërgjegjësuere, trajnuese dhe për forcimin e kapaciteteve në fushën e kujdesit alternativ në familje;
- b) mbështetjes teknike dhe profesionale për bashkitë në proceset e identifikimit të nevojave, përgatitjes dhe mbështetjes së familjeve kujdestare, në përputhje me legjislacionin në fuqi;
- c) ofrimit të trajnimeve, këshillimit profesional dhe mbështetjes psikosociale për familjet kujdestare dhe fëmijët në kujdes alternativ, në bashkëpunim me strukturat përgjegjëse;
- ç) pjesëmarrjes në mekanizmat ndërinstitucionalë në nivel vendor, në funksion të koordinimit, referimit dhe monitorimit të rasteve, sipas legjislacionit në fuqi;
- d) mbështetjes së bashkive në monitorimin dhe vlerësimin e zbatimit të planeve të kujdesit alternativ në familje.

7. Njësia e vetëqeverisjes vendore është përgjegjëse për organizimin dhe administrimin e procesit të përfshirjes së organizatave të shoqërisë civile, në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe, në veçanti:

- a) identifikon dhe vlerëson nevojat për mbështetje në fushën e kujdesit alternativ në familje, në bazë të analizës së situatës dhe të dhënave të disponueshme;
- b) shpall thirrje për shprehje interesi ose procedura të tjera transparente përzgjedhjeje për realizimin e bashkëpunimit nëpërmjet kontraktimit të shërbimeve, në përputhje me legjislacionin në fuqi për prokurimin publik apo marrëveshjeve të bashkëpunimit pa karakter financiar;
- c) administron dhe shqyrton dokumentacionin e paraqitur nga organizatat e interesuara, duke verifikuar përmbushjen e kriterëve të përcaktuara në këtë vendim;
- ç) kryen vlerësimin e kapaciteteve teknike, profesionale dhe organizative të organizatave, kur është e nevojshme edhe nëpërmjet verifikimeve në terren;
- d) lidh marrëveshje bashkëpunimi me organizatat e përzgjedhura, duke përcaktuar qartë rolet, përgjegjësitë, standardet e bashkëpunimit, mekanizmat e raportimit dhe monitorimit;
- dh) mbikëqyr zbatimin e marrëveshjeve të bashkëpunimit dhe cilësinë e mbështetjes së ofruar.

8. Përfshirja e organizatave të shoqërisë civile nuk cenon kompetencat dhe përgjegjësitë e njësive të vetëqeverisjes vendore për vlerësimin, vendimmarrjen, miratimin dhe mbikëqyrjen

ose rishikimin e masave të shërbimit të kujdesit alternativ në familje, sipas legjislacionit në fuqi.

9. Procesi i përfshirjes bazohet në parimet e transparencës, bashkëpunimit, mosdiskriminimit, interesit më të lartë të fëmijës dhe trajtimit të barabartë të subjekteve pjesëmarrëse.

IV. ROLET DHE PËRGJEGJËSITË INSTITUCIONALE

10. Ministria përgjegjëse për çështjet sociale:

- a) siguron koordinimin në nivel kombëtar dhe harmonizimin e praktikave;
- b) ushtron funksionin e monitorimit të përgjithshëm të zbatimit të këtij vendimi.

11. Shërbimi Social Shtetëror:

- a) ofron mbështetje teknike dhe metodologjike për njësitë e vetëqeverisjes vendore;
- b) monitoron cilësinë e mbështetjes dhe aktiviteteve të realizuara nga organizatat;
- c) raporton periodikisht pranë ministrisë përgjegjëse për çështjet sociale.

12. Njësitë e vetëqeverisjes vendore:

- a) organizojnë dhe administrojnë procesin e përfshirjes së organizatave;
- b) lidhin, administrojnë dhe mbikëqyrin zbatimin e marrëveshjeve të bashkëpunimit me organizatat e shoqërisë civile;
- c) garantojnë koordinimin mes strukturave të mbrojtjes së fëmijës dhe aktorëve vendorë;
- ç) raportojnë periodikisht mbi zbatimin e këtij vendimi pranë Shërbimit Social Shtetëror dhe ministrisë përgjegjëse për çështjet sociale, sa herë i kërkohet;
- d) mbajnë dhe administrojnë regjistrin e organizatave të shoqërisë civile të përfshira.

V. DISPOZITA TË FUNDIT

13. Ngarkohen Ministria e Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale, Shërbimi Social Shtetëror dhe njësitë e vetëqeverisjes vendore për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTËR
Edi Rama

SHTOJCA 1

FORMULARI I VLERËSIMIT TË KËRKESAVE TË ORGANIZATAVE TË SHOQËRISË CIVILE PËR PËRFSHIRJEN NË OFRIMIN E SHËRBIMEVE TË KUJDESIT ALTERNATIV NË FAMILJE

I. Qëllimi i formularit

Kjo shtojcë përcakton kriteret, dokumentacionin provues dhe mënyrën e pikëzimit të kërkesave të paraqitura nga organizatat jofitimprurëse, me qëllim vlerësimin e kapaciteteve të tyre për përfshirjen në ofrimin e shërbimeve të kujdesit alternativ në familje.

Formulari përdoret nga komisioni i ngritur nga bashkia, në bashkëpunim me strukturat përgjegjëse në organizimin dhe administrimin e procesit të përfshirjes së organizatave, për të siguruar një proces vlerësimi objektiv, transparent, të krahasueshëm dhe të bazuar në dokumentacion.

II. Të dhëna të përgjithshme për subjektin aplikues

Nr.	Të dhëna për subjektin	Përshkrimi
1	Emri i plotë i subjektit	
2	Forma juridike	
3	Numri unik i identifikimit/NIPT-i	
4	Data e regjistrimit	
5	Adresa e selisë	
6	Përfaqësuesi ligjor	

7	Personi i kontaktit	
8	Email/telefon	
9	Zona territoriale ku kërkohet ofrimi i shërbimit	
10	Lloji i shërbimit që kërkohet të ofrohet	

III. Dokumentacioni i detyrueshëm për pranimin e kërkesës

Komisioni vendor verifikon fillimisht plotësimin e dokumentacionit të detyrueshëm. Mungesa e një prej dokumenteve të mëposhtme, kur nuk plotësohet brenda afatit të caktuar, përbën shkak për moskalimin e kërkesës në fazën e vlerësimit me pikë.

Nr.	Dokumentacioni i detyrueshëm	Po	Jo	Shënime
1	Kërkesa formale për mbështetjen në ofrimin e shërbimit			
2	Ekstrakti aktual dhe/ose historik i regjistrimit			
3	Statuti dhe akti i themelimit			
4	Dokument që provon objektin e veprimtarisë në fushën e shërbimeve sociale, mbrojtjes së fëmijës, kujdesit alternativ ose fusha të lidhura			
5	Licenca për ofrimin e shërbimeve shoqërore, kur kërkohet nga legjislacioni në fuqi			
6	Deklaratë për mungesën e konfliktit të interesit			
7	Deklaratë për vërtetësinë e dokumentacionit të paraqitur			
8	Dokumentacion që provon se subjekti nuk është në procedurë falimentimi, likuidimi ose pezullimi veprimtarie			
9	Vërtetim për shlyerjen e detyrimeve tatimore dhe kontributeve, sipas legjislacionit në fuqi			
10	Politika e mbrojtjes së fëmijës ose dokument i barasvlershëm			

IV. Kriteret e vlerësimit dhe pikëzimi

Vlerësimi i kërkesës bëhet mbi bazën e 100 pikëve. Kërkesa konsiderohet e pranueshme për miratim nëse subjekti merr jo më pak se 70 pikë në total dhe nuk rezulton me mangësi thelbësore në kriteret e integritetit, sigurisë dhe mbrojtjes së fëmijës.

Nr.	Kriteri i vlerësimit	Pikët maksimale
1	Kriteret ligjore dhe administrative	15 pikë
2	Përvoja profesionale dhe teknike	25 pikë
3	Kapacitetet organizative dhe të menaxhimit	20 pikë
4	Kapacitetet financiare dhe qëndrueshmëria	15 pikë
5	Integriteti, siguria dhe mbrojtja e fëmijës	20 pikë
6	Bashkëpunimi institucional dhe mbulimi territorial	5 pikë
7	Totali	100 pikë

V. Formulari i detajuar i vlerësimit

1. Kriteret ligjore dhe administrative 15 pikë

Nr.	Nënkriteri	Dokumentacioni provues	Pikët maksimale	Pikët e dhëna	Shënime
1.1	Subjekti është i regjistruar sipas legjislacionit në fuqi	Ekstrakt regjistrimi	3		
1.2	Objekti i veprimtarisë lidhet me shërbimet sociale, mbrojtjen e fëmijës, kujdesin alternativ ose fusha të ngjashme	Statut, akt themelimi, ekstrakt	4		
1.3	Subjekti nuk është në falimentim, likuidim ose pezullim veprimtarie	Vërtetim/deklaratë përkatëse	2		
1.4	Nuk ka konflikt interesi me autoritetet vendimmarrëse	Deklaratë për mungesë konflikti interesi	2		
1.5	Subjekti është i pajisur me licencë, kur kjo kërkohet nga ligji	Licencë ose dokument ekuivalent	4		
	Totali		15		

2. Përvoja profesionale dhe kapacitetet teknike **25 pikë**

Nr.	Nënkriteri	Dokumentacioni provues	Pikët maksimale	Pikët e dhëna	Shënime
2.1	Përvojë e dokumentuar në fushën e mbrojtjes së fëmijës, kujdesit alternativ ose shërbimeve sociale	Lista e projekteve, kontrata, marrëveshje, raporte	7		
2.2	Përvojë e gjatë dhe e qëndrueshme në ofrimin e shërbimeve të ngjashme	Dokumentacion që provon vitet e veprimtarisë	4		
2.3	Ekip multidisiplinar i përbërë nga profesionistë të kualifikuar	Organigramë, CV, kontrata pune	5		
2.4	Punonjës socialë dhe/ose psikologë të licencuar, kur kërkohet nga legjislacioni	Licenca profesionale, certifikata	4		
2.5	Metodologji e strukturuar për menaxhimin e rastit	Manuale pune, procedura, formate vlerësimi	3		
2.6	Kapacitet për ofrim të vazhdueshëm të shërbimit	Plan pune, burime njerëzore, mjete logjistike	2		
	Totali		25		

3. Kapacitetet organizative dhe të menaxhimit **20 pikë**

Nr.	Nënkriteri	Dokumentacioni provues	Pikët maksimale	Pikët e dhëna	Shënime
3.1	Strukturë e qartë organizative dhe ndarje funksionesh	Organigramë, përshkrime pune	4		
3.2	Procedura të brendshme për administrimin e shërbimit	Rregullore e brendshme, manuale procedurash	3		
3.3	Politikë për mbrojtjen e fëmijës	Politikë e miratuar, protokolle raportimi	4		
3.4	Politikë për etikën profesionale dhe konfidencialitetin	Kod etik, deklarata konfidencialiteti	3		
3.5	Procedura për mbrojtjen e të dhënave personale	Politika e privatësisë, rregulla arkivimi	2		
3.6	Sisteme të dokumentimit, raportimit dhe ruajtjes së të dhënave	Formate raportimi, regjistra, sistem arkivimi	2		
3.7	Mekanizma të brendshëm monitorimi dhe vlerësimi të cilësisë	Raporte monitorimi, formularë vlerësimi, plan përmirësimi	2		
	Totali		20		

4. Kapacitetet financiare dhe qëndrueshmëria **15 pikë**

Nr.	Nënkriteri	Dokumentacioni provues	Pikët maksimale	Pikët e dhëna	Shënime
4.1	Kapacitet i provuar për menaxhimin e fondeve publike ose të donatorëve	Kontrata, raporte financiare, projekte të mëparshme	4		
4.2	Pasqyra financiare të rregullta	Pasqyra financiare vjetore	3		
4.3	Sisteme të brendshme kontrolli financiar	Procedura financiare, rregullore, auditime	3		

4.4	Transparencë dhe raportim financiar	Raporte vjetore, publikime, auditime	2		
4.5	Qëndrueshmëri financiare për periudhën e ofrimit të shërbimeve të përcaktuara në këtë vendim	Plan financiar, burime financimi, buxhet orientues	3		
	Totali		15		

5. Integriteti, siguria dhe mbrojtja e fëmijës **20 pikë**

Nr.	Nënkriteri	Dokumentacioni provues	Pikët maksimale	Pikët e dhëna	Shënime
5.1	Procedura për verifikimin e integritetit të familjarëve që punojnë me fëmijë	Procedura të brendshme, dëshmi penalteti, deklarata integriteti	5		
5.2	Mjedise dhe praktika të sigurta për fëmijët	Protokolle sigurie, rregulla pune, verifikim në terren	5		
5.3	Procedura për raportimin e rasteve të dhunës, abuzimit, neglizhimit ose shfrytëzimit	Protokolle raportimi, formularë referimi	5		
5.4	Respektimi i parimit të interesit më të lartë të fëmijës	Politika, metodologji pune, raste të dokumentuara	5		
5.5	Trajnim i stafit për mbrojtjen e fëmijës, etikën dhe menaxhimin e rasteve të ndjeshme	Certifikata trajnimi, plane trajnimi	5		
	Totali		20		

6. Bashkëpunimi institucional dhe mbulimi territorial **5 pikë**

Nr.	Nënkriteri	Dokumentacioni provues	Pikët maksimale	Pikët e dhëna	Shënime
6.1	Përvojë në bashkëpunim me institucionet publike vendore ose qendrore	Marrëveshje bashkëpunimi, rekomandime, raporte pune	2		
6.2	Kapacitet për bashkëpunim me NJMF, PMF, SHSSH, ASHDMF dhe struktura të tjera përgjegjëse	Protokolle bashkëpunimi, përvojë e mëparshme	2		
6.3	Mbulim territorial i përshtatshëm për zonën ku kërkohet ofrimi i shërbimit	Zyrë vendore, staf në terren, plan mbulimi	1		
	Totali		5		

VI. Përmbledhja e vlerësimit

Kategoria	Pikët maksimale	Pikët e dhëna
Kriteret ligjore dhe administrative	15	
Përvoja profesionale dhe teknike	25	
Kapacitetet organizative dhe të menaxhimit	20	
Kapacitetet financiare dhe qëndrueshmëria	15	
Integriteti, siguria dhe mbrojtja e fëmijës	20	
Bashkëpunimi institucional dhe mbulimi territorial	5	
Totali	100	

VII. Klasifikimi i kërkesës

Në bazë të pikëve të marra, komisioni bën klasifikimin, si vijon:

Pikët e marra	Vlerësimi	Rezultati
85–100 pikë	Shumë mirë	Subjekti ka kapacitete shumë të mira për ofrimin e shërbimit.
70–84 pikë	Mirë	Subjekti plotëson kriteret bazë dhe mund të përfshihet në ofrimin e shërbimit.
50–69 pikë	I pamjaftueshëm	Subjekti ka mangësi që pengojnë përfshirjen në ofrimin e shërbimit.
0–49 pikë	I papranueshëm	Subjekti nuk plotëson kriteret minimale.

VIII. Verifikimi në terren

1. Kur njësia e vetëqeverisjes vendore gjatë procesit të përzgjedhjes e vlerëson të nevojshme, para marrjes së vendimit përfundimtar kryhet verifikim në terren pranë subjektit aplikues.

2. Verifikimi në terren ka për qëllim të konfirmojë saktësinë e dokumentacionit të paraqitur dhe kapacitetet reale të subjektit për ofrimin e shërbimit.

3. Verifikimi në terren mund të përfshijë:

- kontrollin e mjediseve ku ushtrohet veprimtaria;
- verifikimin e stafit të deklaruar;
- shqyrtimin e dokumentacionit të brendshëm;
- vlerësimin e mënyrës së ruajtjes së të dhënave;
- verifikimin e procedurave për mbrojtjen e fëmijës;
- dh) intervista me përfaqësues të subjektit dhe, kur është e përshtatshme, me profesionistët e angazhuar.

4. Gjetjet e verifikimit në terren pasqyrohen në procesverbal dhe bëhen pjesë e dosjes së vlerësimit.

IX. Përfundimi i shqyrtimit të dokumentacionit

Pas shqyrtimit të dokumentacionit, pikëzimit të kriterëve dhe, kur është rasti, verifikimit në terren, jepet një nga përfundimet e mëposhtme:

Përfundimi	Shëno me "X"
Kërkesa pranohet dhe subjekti rekomandohet për përfshirje në ofrimin e shërbimit	
Kërkesa pranohet me kusht plotësimin e mangësive brenda afatit të përcaktuar	
Kërkesa nuk pranohet për shkak të mosplotësimit të kriterëve	
Kërkesa nuk pranohet për shkak të dokumentacionit të pavërtetë ose të pasaktë	

X. Arsyetimi i përzgjedhjes

Arsyetimi i përmbledhur mbi rezultatin e vlerësimit, duke evidentuar kapacitetet kryesore të subjektit, mangësitë e konstatuara, si dhe rekomandimet përkatëse.

Arsyetimi:

XI. Rekomandime dhe masa për plotësim

Në rast se kërkesa pranohet me kusht ose kur konstatohet nevoja për përmirësim, i përcaktohen masat që duhet të plotësohen nga subjekti.

Nr.	Mangësia konstatuar	Masa që duhet të merret	Afati plotësim për	Institucioni/struktura përgjegjëse për ndjekje
1				
2				

3				

XII. Nënshkrimi i komisionit

Nr.	Emër, mbiemër	Institucioni	Funksioni	Nënshkrimi
1			Kryetar	
2			Anëtar	
3			Anëtar	
4			Anëtar	
5			Anëtar	

Data: ____ / ____ / ____

Vendi: _____

**Shënime për përdorimin e formularit*

1. Formulari plotësohet për çdo kërkesë të paraqitur nga organizatat jofitimprurëse.
2. Çdo pikë e dhënë duhet të mbështetet në dokumentacionin e paraqitur ose në gjetjet e verifikimit në terren.
3. Komisioni nuk mund të japë pikë për kritere për të cilat nuk ka dokumentacion provues të mjaftueshëm.
4. Në rast dyshimi për saktësinë e dokumentacionit, komisioni kërkon sqarime shtesë ose kryen verifikime pranë institucioneve përgjegjëse.
5. Formulari i plotësuar, dokumentacioni provues dhe procesverbalet përkatëse ruhen në dosjen e vlerësimit të subjektit.